

VENDIM
Nr.358, datë 4.5.2011

**PËR PËRFSHIRJEN NË PROGRAMIN SOCIAL TË STREHIMIT TË FAMILJEVE QË
BANOJNË NË GODINAT E UNIVERSITETIT BUJQËSOR, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 4 e 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshirjen në programin social të strehimit të familjeve që banojnë në godinat e Universitetit Bujqësor të Tiranës, sipas listave të aneksit A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Klasifikimi i këtyre familjeve në programin social të strehimit miratohet nga këshilli bashkiak, Tiranë.

3. Kriteret për përzgjedhjen e bankës së nivelit të dytë dhe kushtet e kreditimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

4. Godinat e liruara nga familjet e trajtuara me program social, sipas këtij vendimi, merren në dorëzim nga organi shtetëror, i cili ka përgjegjësinë e administrimit të tyre.

5. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha